

---

## ATTITUDES OF STUDENTS OF "UKSHIN HOTI" UNIVERSITY, PRIZREN REGARDING ONLINE LEARNING

**Fatmir Mehmeti**

University "Ukshim Hoti", Faculty of Education, Kosovo, [fatmir.mehmeti@uni-prizren.com](mailto:fatmir.mehmeti@uni-prizren.com)

**Hysen Balaj**

University "Ukshin Hoti", Faculty of Education, Kosovo, [hysen.balaj@hotmail.com](mailto:hysen.balaj@hotmail.com)

**Abstract:** This paper aims to identify the attitudes of the "Ukshin Hoti" University students in Prizren regarding the online learning. The paper also aims to determine whether the approach differ depending on student gender, residence and tools used throughout the online learning, including the studying program as well. The descriptive-research method has been used to elaborate the issue selected from the quantitative approach. The sample consists of 254 students who are attending studies in the academic year 2020-2021, at the Faculty of Education, the Faculty of Law and the Faculty of Economics. In order to collect sufficient data to examine the issue we used the "survey" technique with its instrument - the "questionnaire". The Likert type questionnaire consists of five scales: "Strongly disagree", "Disagree", "Neither agree nor disagree", "Agree", and "Strongly agree". The collected data were transferred to the Statistical Program for Social Sciences (SPSS) v.25, where they have been processed. The Independent Sample Test has been used to examine whether there are differences in approach between the online learning and student gender, residence and use of electronic devices. Similarly, One-Way ANOVA has been used to examine whether there are differences between the student approach regarding the online learning and the study program. The conclusions deriving from the examination indicates an average of 3.04 points, which means a distance close to the two opposite ends (positive and negative). Thus, we may conclude that students were undetermined in their approach regarding the online learning. Also, there were no significant differences between student approach between the online learning and gender, student residence, use of electronic means and studying program.

**Keywords:** students, attitudes, approach, online learning, etc.

## QËNDRIMET E STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI", PRIZREN LIDHUR ME MËSIMIN ONLINE

**Fatmir Mehmeti**

Universiteti "Ukshim Hoti", Fakulteti i Edukimit, Kosovë, [fatmir.mehmeti@uni-prizren.com](mailto:fatmir.mehmeti@uni-prizren.com)

**Hysen Balaj**

Universiteti "Ukshin Hoti", Fakulteti i Edukimit, Kosovë, [hysen.balaj@hotmail.com](mailto:hysen.balaj@hotmail.com)

**Abstrakt:** Ky punim ka për qëllim identifikimin e qëndrimeve të studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren lidhur me mësimin online. Gjithashtu, punimi ka për qëllim të përcaktojë nëse qëndrimet ndryshojnë në varësi të gjinisë, vendbanimit të studentëve, mjeteve të përdorura përgjatë mësimin online si dhe programit të studimeve. Për problemin e përzgjedhur nga qasja kuantitative (sasiore) është përzgjedhur metoda deskriptive - kërkimore. Mostra është e përbërë nga 254 studentë të cilët ndjekin studimet në vitin akademik 2020-2021, në Fakultetin e Edukimit, Fakultetin e Juridikut si dhe Fakultetin Ekonomik. Për grumbullimin e të dhënave të mjaftueshme për hulumtimin e problemit përdorëm teknikën e "anketës" me instrumentin e saj, "pyetësorin". Pyetësori i përket tipit Likert, i përbërë nga pesë shkallë, "Plotësisht nuk pajtohem", "Nuk pajtohem", "I pa vendosur", "Pajtohem" dhe "Plotësisht pajtohem". Të dhënat e mbledhura janë bartur në programin Statistical Program for Social Sciences (SPSS) v.25, ku edhe janë përpunuar. Për të analizuar se a ekzistojnë dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe gjinisë, vendbanimin e studentëve si dhe përdorimin e mjeteve elektronike është përdorur analiza: Independent Samples Test. Ndërsa, për të analizuar se a ekzistojnë dallimet ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe programit të studimeve është përdorur analiza ANOVA Njësore. Përfundimet e dala nga analizat e realizuara na tregojnë që mesatarja e pikëve të qëndrimeve është 3.04, domethënë ato janë në distancë pothuajse të afërt nga dy skajet e kundërta (pozitive dhe negative), pra mund të themi se studentët janë të pavendosur në qëndrimet e tyre lidhur me mësimin online. Gjithashtu, nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe gjinisë, vendbanimit të studentëve, përdorimit të mjeteve elektronike si dhe programit të studimeve.

**Fjalët kyçe:** Studentët, qëndrimet, qasja, mësimi online,

## 1. HYRJE

Padyshim që zhvillimet në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit tashmë kanë prekur të gjitha fushat e jetës. Ky zhvillim i shpejtë, ka hapur rrugë për ndryshime rrënjësore në fusha të ndryshme, gjithashtu edhe në fushën e arsimit. Njëra nga këto ndryshime është edhe evitimi i pengesave si vendi, koha, mosha në qasjen e informacionit, ku mund të themi se është bërë përhapja e konceptit të arsimit në distancë, e cila kontribuon gjithashtu në të mësuarit gjatë gjithë jetës. Arsimi në distancë cilësohet si teknologji sistematike arsimuese që në proceset e arsimit, marrësit të njohurive i ofron burime dhe mundësi të pavarësisë dhe të fleksibilitetit në kontekstin e kohës si dhe vendit, duke mundësuar që marrësi i informatës të jetë në ambiente të ndryshme (Uşun, 2006). Liaw, Huang dhe (2007), theksojnë se përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe internetit si mjet mësimor tash po zgjerohet me shpejtësi. Të mësuarit elektronik është një nga mjediset më të njohura të mësimit në epokën e informacionit. Kështu, përpjekjet dhe eksperimentet e të mësuarit elektronik aktualisht marrin vëmendje të jashtëzakonshme në të gjithë globin. Më 12 mars 2020, nga rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës, mori vendim që të kalohet nga të mësuarit e zakonshëm, gjegjësisht nga institucionet arsimore në të mësuarit në distancë. Ky kalim i preku të gjitha nivelet e arsimit. Për nivelin parauniversitar, u organizuan video - materiale të cilat u transmetuan në televizionin publik të Kosovës (RTK1 dhe RTK4). Për dallim nga arsimi parauniversitar, mësimi në arsimin e lartë filloi të zhvillohej përmes mësimit online. Përmes platformës Google Meet, studentët ndoqën ligjëratat nga mjediset ku jetojnë. Në fillimet e zbatimit të një modaliteti të tillë, pa pasur përgatitje paraprake, rezultoi në hasjen e sfidave të ndryshme si nga ana e mësimitdhënësve ashtu edhe nga ana e studentëve. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij punimi është identifikimi i qëndrimeve të studentëve të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren lidhur me mësimin online. Gjithashtu, përcaktimi nëse qëndrimet e studentëve ndryshojnë në varësi të gjinisë, vendbanimit të studentëve, mjetet e përdorura përgjatë mësimit online si dhe programit të studimeve.

Në përputhje me qëllimin e studimit, u kërkohet përgjigje pyetjeve kërkimore si në vijim:

1. Çfarë janë qëndrimet e studentëve të Universiteti të Prizrenit ndaj mësimit online?
2. A ekzistojnë dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimit online dhe gjinisë së tyre?
3. A ekzistojnë dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimit online dhe vendbanimit së tyre?
4. A ekzistojnë dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimit online dhe mjeteve me të cilat i ndjekin ligjëratat?
5. A ekzistojnë dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimit online dhe drejtimit në të cilin ndjekin studimet ?

## 2. MATERIALET DHE METODAT

Për problemin e përzgjedhur nga qasja kuantitative (sasiore) është përzgjedhur metoda përshkruese – kërkimore. Metoda përshkruese kërkimore, përfshin hulumtimet të cilat realizohen në grupe të mëdha, për t'i marrë mendimet e tyre, për t'i vëzhguar këndvështrimet e individëve që preokupohen për ndonjë ngjarje apo fakt, njashtu edhe mënyrën se si i përshkruajnë këto ngjarje (Karakaya, 2012). Kjo metodë e hulumtimit është përdorur t'i definojë strukturat e objekteve, shoqërive, organizatave gjithashtu edhe mekanizmat e ngjarjeve (Cohen, Manion & Morrison, 2007). Mostra është e përbërë nga 254 studentë të cilët ndjekin studimet në vitin akademik 2020-2021 në Fakultetin e Edukimit, Fakultetin Juridik si dhe Fakultetin Ekonomik. Për grumbullimin e të dhënave të mjaftueshme për hulumtimin e problemit përdorëm teknikën e “anketës” me instrumentin e saj, “pyetësorin”. Pyetësori është i përbërë nga dy pjesë. Pjesa e parë ka për qëllim grumbullimin e të dhënave demografike të studentëve, ndërsa pjesa e dytë përmban 20 shprehje në formën pohuese dhe mohuese lidhur me mësimin online. Pyetësori i përket tipit Likert, i përbërë nga pesë shkallë, “Plotësisht nuk pajtohem”, “Nuk pajtohem”, “I pa vendosur”, “Pajtohem” dhe “Plotësisht pajtohem”. Shkalla e besueshmërisë (Reliability Statistics) së pyetësorit është vërtetuar me analizën Cronbach's Alpha = .830. Të dhënat e mbledhura janë bartur në programin Statistical Program for Social Sciences (SPSS) v.25, ku edhe janë përpunuar. Për të vërtetuar se a ekzistojnë dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe gjinisë, vendbanimit të studentëve si dhe përdorimit të mjeteve elektronike është përdorur analiza: Independent Samples Test. Ndërsa, për të vërtetuar se a ekzistojnë dallimet ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe programit të studimeve është përdorur analiza ANOVA njëdrejtimitëshe.

### 3. INTERPRETIMI I TË DHËNAVE

**Tabela 1. Gjinia e pjesëmarrësve të anketuarve**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Vajza	184	72.4	72.4	72.4
	Djem	70	27.6	27.6	100.0
	Total	254	100.0	100.0	

Në tabelën 1 janë paraqitur të dhënat lidhur me gjininë e pjesëmarrësve të anketuar. Nga gjithsej 254 pjesëmarrës të anketuar, 72.4% prej tyre janë vajza, kurse 27.6% janë djem.

**Tabela 2. Vendbanimi i të anketuarve**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Qytet	109	42.9	42.9	42.9
	Fshat	145	57.1	57.1	100.0
	Total	254	100.0	100.0	

Tabela 2 paraqet vendbanimin e studentëve të anketuar. Nga 254 studentë, 42.9 % jetojnë në qytet, kurse 57.1 % jetojnë në fshat.

**Tabela 3. Fakulteti**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Fakulteti i Edukimit	105	41.3	41.3	41.3
	Fakulteti Juridik	92	36.2	36.2	77.6
	Fakulteti Ekonomik	57	22.4	22.4	100.0
	Total	254	100.0	100.0	

Përqindja më e madhe e studentëve të anketuar janë nga Fakulteti i Edukimit 41.3 %, duke pasur nga studentët e Fakultetit Juridik 36.2% dhe me një përqindje më të vogël nga studentët e Fakultetit Ekonomik 22.4%.

**Tabela 4. Mënyra e ndjekjes së ligjëratave online**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Laptop	92	36.2	36.2	36.2
	Telefon	162	63.8	63.8	100.0
	Total	254	100.0	100.0	

Tabela 4 paraqet të dhënat lidhur me mënyrën e ndjekjes së ligjëratave nga ana e studentëve. Përqindja më e madhe e studentëve 63.8% kanë deklaruar se ligjëratat i ndjekin përmes telefonit, ndërsa pjesa tjetër e mbetur 36.2% përdorin laptopin për t'i ndjekur ligjëratat online.

**Tabela 5. Mesatarja e pikëve të qëndrimeve**

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Mesatarja	254	1.55	4.75	3.0486	.40665
Valid N (listwise)	254				

Analiza përshkruese në Tabelën 5 na tregon që mesatarja e pikëve të qëndrimeve është 3.04, domethënë ato janë në distancë pothuajse të afërta nga dy skajet e kundërta (pozitive dhe negative), pra mund të themi se studentët janë të përvendosur në qëndrimet e tyre lidhur me mësimin online. Minimalja e pikëve është 1.55, kurse maksimalja 4.75.

**Tabela 6. Rezultatet nga Independent Sample Test**

Gjinia	N	X	Std. Dev	df	t	P
Vajza	184	3.05	.40	252	.208	.835
Djem	70	3.04	.40			

Për të vërtetuar se a ka dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe gjinisë së tyre, është përdorur analiza Independent Sample Test. Rezultatet në Tabelën 6 tregojnë se nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimin online dhe gjinisë së tyre ( $t=.208, p> 0.05$ ).

**Tabela 7. Rezultatet nga Independent Sample Test**

Vendbanimi	N	X	Std. Dev	df	t	P
Qytet	109	3.05	.43	252	.156	.876
Fshat	145	3.0	.38			

Për të vërtetuar se a ka dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe vendbanimit të tyre, është përdorur analiza Independent Sample Test. Rezultatet në tabelën 7 na reflektojnë se nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimin online dhe vendbanimit të tyre ( $t=.156, p> 0.05$ ).

**Tabela 8. Rezultatet nga Independent Sample Test**

Ligjëratat	N	X	Std. Dev	df	T	P
Laptop	92	3.04	.42	252	.184	.854
Telefon	162	3.05	.39			

Për të vërtetuar se a ka dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve lidhur me mësimin online dhe mënyrës së ndjekjes së ligjëratave, është përdorur analiza Independent Sample Test. Nga përfundimet e dala shohim se nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimin online dhe mënyrës së ndjekjes së ligjëratave ( $t=.184, p> 0.05$ ).

**Tabela 9. Rezultatet nga analiza Anova Njëdrejtimëshe**

	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	.191	2	.096	.577	.563
Within Groups	41.646	251	.166		
Total	41.837	253			

Për të vërtetuar se a ekzistojnë dallime ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimin online dhe drejtimit në të cilin ndjekin studimet, është përdorur analiza Anova Njëdrejtimëshe. Përfundimet tregojnë se nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimin online dhe drejtimit në të cilin ndjekin studimet ( $t=.563, p> 0.05$ ).

#### 4. PËRFUNDIME

Qëllimi i këtij punimi ishte identifikimi i qëndrimeve të studentëve të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren lidhur me mësimin online si dhe përcaktimi nëse qëndrimet ndryshojnë në varësi të gjinisë, vendbanimit të studentëve, mjeteve të përdorura përgjatë mësimin online si dhe programit të studimeve. Përfundimet e dala nga analizat e realizuara na tregojnë që mesatarja e pikëve të qëndrimeve është 3.04, domethënë ato janë në distancë pothuajse të afërt nga dy skajet e kundërta (pozitive dhe negative), pra, mund të themi se studentët janë të pavendosur në qëndrimet e tyre lidhur me mësimin online. Rezultatet e dala, përputhen me gjetjet e Baris (2001) dhe Ates (2008). Qëndrimet e studentëve lidhur me mësimin online nuk dallojnë varësisht nga gjinia e tyre. Të tilla rezultatet janë hasur edhe në hulumtime të tjera (Dilma, 2020; Bakr, 2011). Ndërsa, në hulumtimet e kryera nga Broos (2005) dhe Fidan (2016), rezultojnë që studentët e gjinisë femërore të kenë qëndrime negative lidhur me mësimin online. Si rezultat i analizave të kryera për të përcaktuar nëse ka dallime në qëndrimet e studentëve ndaj mësimin online sipas fakultetit në të cilin studiojnë, nuk u vunë re ndryshime të konsiderueshme. Gjithashtu, nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet qëndrimeve të studentëve ndaj mësimin online dhe vendbanimit të tyre si dhe mënyrës së ndjekjes së ligjëratave. Rezultatet e pasqyruara mund të jetë për shkak të mungesës së njohurive dhe përvojës së studentëve në mësim online dhe zbatimet e tij. Mund të themi se qasja e mësimin online nuk është e përhapur në vendin tonë dhe kjo çështje nuk mund të adresohet në mënyrë adekuate.

#### 5. KONKUZIONE

Studentët janë të pavendosur në qëndrimet e tyre lidhur me mësimin online. Një pjesë e konsiderueshme e studentëve të anketuar përballen me shumë probleme përgjatë përcjelljes së mësimin online. Për ta, mësimi online nuk shton interesim për mësimnxënie. Kjo mund të jetë e lidhur me stilin e tyre të të nxënies, me ritmin e të mësuarit apo edhe mos dëshirës që të mësojnë në mjediset e tilla. Faktor tjetër është edhe mbështetja jo e mjaftueshme e ligjëruesve në mësimin online, për këtë arsye një pjesë e studentëve janë të mendimit se mësimi online nuk e rrit produktivitetin e mësimnxënies. Derisa një pjesë e studentëve e shohin mësimin online si më argëtuese dhe e cila e rrit suksesin e tyre, pjesa tjetër kanë mendime të kundërta dhe i shqetëson fakti se përgjatë mësimin online nuk ka ndërveprime ballë për ballë. Pas këtyre gjetjeve, mund të jetë e dobishme që të merren hapat e nevojshme për

përmirësimin e gjendjes në universitet lidhur me mësimin online. Universiteti duhet që të jetë më i informuar për punën aktive të mësimin online, duke marrë problemet teknike nën kontroll, dizajnimin e mjedisit ku ligjëruesit dhe studentët do të jenë në kontakt të vazhdueshëm dhe studentët ta kenë më të lehtë qasjen dhe të jenë më të motivuar lidhur me mbajtjen e mësimin online.

#### LITERATURA

- Ates, A. (2008). Investigating Preservice Computer Teachers' Attitudes Towards Distance Learning Regarding Various Variables. *GÜ, Gazi Eğitim Fakültesi Dergisi*, 28(3), 125-145.
- Bakr, S. (2011). Attitudes of Egyptian Teachers towards Computers. *Contemporary Educational Technology*, 308-318.
- Baris, M. (2015). Üniversite Öğrencilerinin Uzaktan Öğretime Yönelik Tutumlarının İncelenmesi: Namık Kemal Üniversitesi Örneği. *Sakarya University Journal of Education*, 34-46.
- Broos, A. (2005). Gender and Information and Communication Technologies (ICT) anxiety: Male self-assurance and female hesitation. *Cyber Psychology & Behavior*, 21-31.
- Cohen, L., Manion, L., & Morrison, K. (2007). *Research methods in education*. NewYork: Routledge.
- Dilma, S. (2020). Students' Opinions about the Distance Education to Art and Design Courses in the Pandemic Process. *World Journal of Education*, 113-126.
- Fidan, M. (2016). Distance Education Students' Attitudes Towards Distance Education and Their Epistemological Beliefs. *Hacettepe University Journal of Education*, 536-550.
- Karakaya, I. (2012). *Bilimsel araştırma yöntemleri*. . Ankara: Ani Yayıncılık.
- Liaw, S.-S., Huang, H.-M., & Chen, G.-D. (2007). Surveying instructor and learner attitudes toward e-learning. *Science Direct*, 1066-1080.
- Uşun, S. (2006). *Uzaktan eğitim*. Ankara: Nobel Yayın Dağıtım.